



I dashur Prind/Kujdestar !

Në epokën e celularëve, smartfonëve dhe paisjeve të tjera elektronike, me të cilat me lehtësi mund të bëjmë fotografi dhe t'i shpërndajmë ato në çast, konfidencialiteti dhe siguria e materialeve të testeve, mundet të kompromentohen lehtësisht. Jo vetëm për faktin që është e kushtueshme zëvendësimi i materialeve të kompromentuara, por materiali që gjendet në testin e PSSA, ACCESS for ELs 2.0 dhe Provimeve Keystone (Keystone Exams), është pasuri dhe e drejtë e Shtetit të Pensilvanisë. Kopjimi dhe dublikimi i materialeve nga testi, përfshirë edhe marrjen e fotografive, është në shkelje të Ligjit Federal për të drejtat e autorit (Copyright Act). Dënimet për shkeljen e këtij ligji, mund të përfshijnë koston e zëvendësimit të pjesëve të kompromentuara, ose gjobë jo më pak se \$750 deri në \$30,000 , për një shkelje të vetme. 17 U.S.C. § 101 et seq.

Në mënyrë që të garantohet besueshmëria në rezultatet e testeve, dhe të shmanget kostoja e zëvendësimit të tyre, Departamenti i Arsimit kërkon që shkollat të vendosin rregulla dhe të marrin masa për ruajtjen e materialeve të testeve. Një masë, ose rregull kërkon që të mos lejohen në mjediset e testit paisjet elektronike. Këto paisje përfshijnë celularët, smartphones, E-readers, Nooks, Kindles, iPads, iPods, tablets, camera-ready devices, dhe të tjera, të cilat mund të përdoren për fotografi, ose dublikim të materialeve të testeve, lidhje me internetin dhe/ose komunikim me të tjerët gjatë procesit të provimeve të PSSA, ACCESS for ELs 2.0 ose Keystone Exams. Ju lutemi bisedoni me fëmijën tuaj dhe i bëni të ditur se mbajtja dhe/ose përdorimi i celularit, ose paisjeve të tjera elektronike gjatë testimit të PSSA ose Keystone Exams, do të ketë pasoja.

Ju do të kontaktoheni nga shkolla, në rast se do të rezultojë që fëmija juaj ka/ose përdor paisje elektronike gjatë testit të PSSA, ACCESS for ELs 2.0 ose Keystone Exams. Nxënësit që nuk i përmbahen këtij rregulli, do të jenë subjekt i masave disiplinore të shkollës dhe kërkesave të Departamentit të Arsimit, për përjashtim nga testi dhe përsëritjen e plotë të këtij testi. Në vazhdim, do të mbahen paisjet elektronike dhe do të kontrollohen fotot e ruajtura në to. Personeli i shkollës do të kërkojë lejen tuaj për kontrollin e funksioneve të tjera të paisjes elektronike. Në rast se zbulohen foto të testit, ose refuzohet leja për kontrollin e funksioneve të tjera të paisjes, paisja do të mbahet nga personeli, sepse Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë ka të drejtat e autorit për materialet që përmbajnë testet e PSSA, ACCESS for ELs 2.0 dhe Keystone Exams. Në këtë rast do të kontaktohet edhe Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë, për veprime të mëtejshme.

Në rastet kur pas përfundimit të testit dhe dorëzimit të materialeve zbulohet që një nxënës ka patur, ose/dhe ka përdorur paisje elektronike gjatë kohës së testit, do të zbatohet politika disiplinore e shkollës dhe rezultati i testit të nxënësit do të bëhet i pavlefshëm.